



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

Legjislatura V  
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6.1 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare, të mbajtur më 5 gusht 2016, me propozimin e grupeve parlamentare: PDK, LDK, LVV, LS dhe "6+", nxjerr këtë:

## DEKLARATË

Ne përfaqësuesit e zgjedhur të popullit e dënojmë fuqishëm sulmin kriminal, të kryer mbrëmë, mbi Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ky është një sulm kundër shtetit të Kosovës, interesave të qytetarëve tanë dhe kundër qëllimeve dhe vlerave politike e demokratike që afirmojnë subjektet tona politike.

Kërkojmë nga institucionet e sigurisë që t'i ndërmarrin masat e duhura dhe sa më parë ta zbardhin këtë sulm qyqar, ndërsa kriminelët të vihen para drejtësisë.

Kuvendi i Republikës së Kosovës po ashtu u bën thirrje të gjithë qytetarëve të vendit që të bashkëpunojnë dhe t'i ndihmojnë organet e drejtësisë në zbardhjen e këtij akti kriminal.

Nr. 05-D-002  
Prishtinë, 5 gusht 2016

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Deklarata u dërgohet:

- Deputetëve të Kuvendit,
- Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe
- Arkivit të Kuvendit.